



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 404 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

VENDIM Nr. 62 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime sipërfaqësore në rrugën mesjetare Vlorë–Tepelenë"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Skënder Muça dhe doktorante Suela Xhyheri,


VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime sipërfaqësore në rrugën mesjetare Vlorë–Tepelenë"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Skënder Muça dhe doktorant Suela Xhyheri, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmim-sondazhi në kishën e Asomatit.
 - Sondazh (2m x 1m) dhe pastrime në rrënojat e tempullit antik/kishë mesjetare "Maja e Qishës" (Kropisht).
 - Sondazh (1m x 1m) në kishën e "Shën Gjergjit" Brataj.
 - Pastrim nga vegjetacioni në kishën "Bregu i Beshos" Sherishtë.
 - Kërkime sipërfaqësore në lumin e Vlorës.
- II. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë brenda vitit 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al